



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT

VENDIM

Nr.10, datë 29/12/2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “ALBCHROME”
SH.P.K., ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE KOMSI,
BASHKIA BURREL, RRETHI MAT

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli Basenit Lumor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “Albchrome” sh.p.k., me vendndodhje: Uzina ekzistuese e Ferro-Kromit, Njësia Administrative KomsI, Bashkia Burrel, Rrethi Mat.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor:

- X= 497416
- Y= 4605405

- $Z=323$ m
 - Prurja mesatare : $Q_{mes}=1.89$ l/sek
 - Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q=1.89$ l/sek
 - Qëllimi i përdorimit : Industriale, larje minerali në procesin e fraksionimit
 - Thellësia e pus-shpimit: 252 m
 - Thellësia e vendosjes së pompës : 85 m
 - Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

- $X=497356;$	$Y=4605872;$	$Z=317$ m
- $X=497633;$	$Y=4605778;$	$Z=311$ m
- $X=497591;$	$Y=4605297;$	$Z=333$ m
- $X=497350;$	$Y=4605293;$	$Z=338$ m
 - Prurja që shkarkohet: $Q=0.5$ l/sek
3. Subjekti të marri masa për mbrojtjen e burimeve ujore nga shkarkimet industriale që vinë si pasojë e zhvillimit të këtij aktiviteti, në përputhje me Vendim Nr.833, datë 28.12.2023 “Për Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat 2024-2029”:
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBL MAT

TAULANT MALSHI

